



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.794/5 Prot.

Tiranë, më 30/11/2018

V E N D I M

Nr.178, Datë 30.11.2018

Ndryshuar me Vendimin nr. 196, datë 14.12.2018, protokolluar me nr. 794/7, datë 14.12.2018

Për Auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 30.06.2018.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë Aksionare "Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA" (UKS SHA), "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2016 deri më datën 30.06.2018, u konstatuan disa mangësi, të cilat duhet të përmirësohen dhe për zbatimin e të cilave në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt "Auditim financiar dhe përputhshmërie", të ushtruar në UKS SHA, sipas Programit të Auditimit nr. 794/1 prot., datë 13.07.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 30.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të UKS SHA për vitin ushtrimor nga 01.01.2016-31.12.2016 dhe vitin ushtrimor nga 01.01.2017-31.12.2017, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i kualifikuar¹:

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2017, referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion të kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare të dy viteve ushtrimore 2016 dhe 2017 përmbanin të njëjtat gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në rezultatin financiar të shoqërisë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

I. Gjykojmë se angazhimet e marra nga UKS SHA, sipas Marrëveshjeve të Nën-huasë së lidhur me Ministrinë e Financave, duhej të regjistroheshin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së ngjarjes, konkretisht:

- Nga auditimi i pasqyrave financiare ka rezultuar se në vitin 2017, në klasën e “Llogarive jashtë bilancit”, në llogarinë "Investime të papërfunduara" është pasqyruar vlera prej 319,591,667 lekë, e cila i korrespondon në pasiv të bilancit llogarisë "Kredi për t'u njohur jashtë bilancit", referuar “Marrëveshjes së nën-huasë”, së nënshkruar midis UKS SHA dhe Ministrisë së Financave më datë 04.05.2003, veprim i cili nuk është pasqyruar në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

¹ **Opinion i kualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërfundueshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

- UKS SHA ka lidhur Marrëveshje nën-huaje në datë 07.07.2003 me Ministrinë e Financës për shumën 1,390,000 SDR, mbështetur në Marrëveshjen e kredisë së Ministrisë së Financave me IDA me objekt “Projekti bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime”, e cila nuk është regjistruar në kontabilitet në periudhën ushtrimore përkatëse, kur ka ndodhur ngjarja, sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

2. Gjykojmë se angazhimi i marrë nga UKS SHA sipas Marrëveshjeve të nën-huasë së lidhur me Ministrinë e Financave, mbi pagesën e kostove të kredisë (interesa, penalitete dhe komisione) duhej të regjistroheshin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së ngjarjes, duke rënduar në këtë mënyrë periudhat përkatëse ushtrimore për koston e tyre, konkretisht:

- Sipas termave të kredisë UKS SHA me BEI, ka marrë angazhim për shlyerjen e principalit (duke filluar nga viti 2013) dhe të koston së kredisë (interesa dhe penalitete, duke filluar nga viti 2008), për të cilat nuk ka rënduar shpenzimet sipas periudhave përkatëse ushtrimore, por janë akumuluar dhe në fund të vitit 2017 në shumën 353,839.23 EUR interesa dhe 74,072.19 EUR penalitet për mos shlyerje në afat të detyrimeve.

- Sipas termave të kredisë UKS SHA me IDA, ka marrë angazhim për shlyerjen e principalit (duke filluar nga viti 2013) dhe të koston së kredisë (interesa dhe komisione duke filluar nga viti 2008), për të cilat nuk ka rënduar shpenzimet sipas periudhave përkatëse ushtrimore, por janë akumuluar dhe në fund të vitit 2017 rezultojnë në shumën 366,248.62 USD interesa dhe 877.13 USD komisione.

3. Gjykojmë se nga UKS SHA duhet të saktësohet dhe rakordohet vlera e kredive, për të cilat sipas Marrëveshjeve të nën-huasë së lidhur me Ministrinë e Financave, ajo është e angazhuar për shlyerjen e tyre, pasi në UKS SHA nuk është e dokumentuar përdorimi i gjithë vlerës së nën-huasë, destinacioni dhe natyra e shpenzimit, konkretisht:

- UKS SHA ka lidhur Marrëveshje nën-huaje në datë 07.07.2003 me Ministrinë e Financës për shumën 1,390,000 SDR, mbështetur në Marrëveshjen e kredisë së Ministrisë së Financave me IDA me objekt “Projekti bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime”. Sipas Marrëveshjes së nën-huasë në UKS SHA, do të investohej shuma prej 1,390,000 SDR e barabartë me 1,954,443 USD ose me 233,408,800 lekë².

- Sipas rakordimit me Ministrinë e Financave në 31.12.2017, vlera e disbursuar paraqitet në shumën 2,530,820.86 USD, ndërsa vlera e kredisë sipas Marrëveshjes së nën-huasë e shprehur në dollarë është 1,954,443 USD, me një mos rakordim në shumën 576,377 USD.

- Sipas dokumentacionit (situacione dhe fatura) që disponon UKS SHA, është justifikuar përdorimi i fondeve në vlerën 133,040,349 lekë, ndërsa vlera e financimit e shprehur në lekë në datë 07.07.2003 është 233,408,800 lekë. Për diferencën në 100,368,451 lekë, nga zbatuesi i projektit (DPUK/AKUK) nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (pranë UKS SHA) sipas natyrës së shpenzimeve të kryera në kuadër të këtij projekti.

4. Gjykojmë se nga UKS SHA sipas Marrëveshjeve të Nën-huasë së lidhur me Ministrinë e Financave, për efektet e kursit të këmbimit për pagesat e detyrimeve të kredisë principal dhe kosto e kredisë duhej të regjistroheshin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së ngjarjes (sipas kalendarit), duke rënduar në këtë mënyrë periudhat përkatëse ushtrimore, të çdo fundviti³ duke filluar nga viti 2008, konkretisht:

- Shoqëria nuk ka pasqyruar efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit të fund vitit për zërat monetarë të pozicionit financiar, pasi nuk ka kontabilizuar detyrimin e lindur sipas marrëveshjes

² Marrë nga Arkivi i kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, (kursi i këmbimit datë 07.07.2003 SDR/USD dhe SDR/Lekë).

³ Standardi i kontabilitetit SKK 12 “Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit”

së nën-huasë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe gjithë veprimet e tjera që rrjedhin prej saj. Nuk janë pasqyruar në aktiv dhe në pasiv respektivisht në llogaritë 476 “Diferenca konvertimi aktive” dhe 477 “Diferenca konvertimi pasive” me kundërparti llogaritë e shpenzimeve financiare (llogaria 666 “Humbje nga këmbimi”) dhe në të ardhurat financiare (llogaria 766 “Fitime nga këmbimi”).

5. Gjykojmë se nga UKS SHA duhet të kryejë zhvlerësim të zërit të kërkesave të arkëtueshme, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i vërtetë e i besueshëm i pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike, konkretisht:

- Duhet cilësuar se UKS SHA për kërkesat e arkëtueshme dhe në veçanti për abonentët pasivë në vlerën 47,972,672 lekë, nuk ka bërë analizë me qëllim vlerësimin e llogarive të arkëtueshme, vjetërsinë e tyre dhe procedurat për njohjen e provizioneve. Për këtë shkak, për vlerat mbi një vit të kërkesave të arkëtueshme drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin të tyre⁴.

6. Gjykojmë se nga UKS SHA duhet të kryejë rivlerësim të aktiveve⁵ (pasuri të paluajtshme, ndërtesa dhe troje), me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i vlerës reale të tyre, në aktiv të bilancit, konkretisht:

- Ka rezultuar se një pjesë e aktiveve të cilat kanë hyrë në inventar në periudha të mëparshme, rezultojnë me vlera të pa përditësuara me vlerën aktuale të tregut. Me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, me marrjen në dorëzim të aktiveve të Ksamilit, është bërë rivlerësim vetëm i tyre, pa përfshirë aktivet që dispononte UKS SHA.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë.

Për drejtimin e Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Sarandë.

Ne kemi audituar përputhshmërinë⁶ e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e UKS SHA, gjatë periudhave ushtrimore 2016, 2017 deri në 30.06.2018.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së UKS SHA, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator për sa i përket, funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, zbatimit të strukturës organizative, hartimit të programeve ekonomiko-financiare, realizimit të treguesve të performancës, vendimeve të strukturave drejtuese, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

1. Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën 2016-Qershor 2018, për sa ju përket realizimit të treguesve, konkretisht mbi realizimin e të ardhurave, duke vlerësuar nivelin e faturimeve, normën e arkëtimit, humbjet në rrjet, mbulimin me punonjës/lidhje, ka rezultuar me performancë të ulët, por në krahasim me periudhat e mëparshme ka një përmirësim të lehtë të tyre.

2. Për sa i përket menaxhimit të shpenzimeve, kryerjes së tyre në përputhje me kuadrin rregullator

⁴ Standardit të kontabilitetit, SKK 3, “Instrumentat Financiare”.

⁵ Standardi i kontabilitetit SKK 4 “Aktivet afatgjata material dhe jomateriale”

⁶ Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

të fushës, ka rezultuar me mangësi dhe shkelje të cilat konsistojnë:

- a. Në mungesën e kuorumit të nevojshëm të anëtarëve të Këshillit të Administrimit, gjë e cila pengon marrjen e vendimeve për shoqërinë;
- b. Në menaxhimin e aktiveve, ku mungon regjistri i tyre;
- c. Në regjistrimin në kontabilitet i pasurive të paluajtshme (troje dhe ndërtesa), ku jo në të gjitha rastet është mbështetur në dokumentacionin e duhur, pasi jo të gjitha aktivet (troje dhe ndërtesa) janë të pajisura me dokumentin e pronësisë (certifikatë apo vërtetim hipotekor), apo dokument tjetër që vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme.
- ç. Në zbatimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave ku janë evidentuar mospërputhje, të cilat kanë të bëjnë me strukturën, nivelin e pagave, dhe parregullsi në dhënien e shpërblimeve për orë jashtë orarit zyrtar të punës.
- d. Në mungesën e një rregulloreje e brendshme të përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe Statutin e ndryshuar të Shoqërisë, duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj.
- e. Në mungesën e Plan biznesit afatmesëm të miratuar nga organet kolegjiale dhe mungesën e Programeve vjetore ekonomiko-financiare, etj.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë:

Strukturat drejtuese të UKS SHA, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare ka rezultuar se në vitin 2017, në "Llogaritë jashtë bilancit", në aktiv të tij në llogarinë "Investime të papërfunduara" është pasqyruar vlera prej 319,591,667 lekë, e cila i korrespondon në pasiv të bilancit llogarisë "Kredi për t'u njohur jashtë bilancit". Kjo vlerë i përket investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë", sipas raportit të hartuar nga UKS SHA, **nuk është marrë në dorëzim** për shkak të mosplotësimit të parametrave teknikë të parashikuar në kontratë. Përsa i përket investimit të papërfunduar me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë" në vlerën 319,591,667 lekë⁷ dhe regjistrimit të tij si llogari jashtë bilanci, është rezultat i faktit se UKS SHA është përfutuese e investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë". Ky projekt sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (DPUK) sot Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime (AKUK) ka përfunduar më datë 31.12.2011, bazuar në kontratën së lidhur më datë 24.01.2007 ndërmjet Kontraktorit "... " (Itali) dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për ndërtimin e tre impianteve të pastrimit, ku është përfshirë edhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Sarandë. Sipas shkresës nr. 1820, datë 24.07.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (sot Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime) vlera e financimit është në shumën 3,877,126 EUR. Në këtë shkresë është cilësuar se " Referuar kontratës, vlera e përfundimit të punimeve të IPUZ Sarandë është 3,877,126.92 EUR, përkatësisht financiar si më poshtë:

Vlera prej 798,397 EUR, nga Banka Botërore (Grant)

Vlera prej 2,432,541 EUR, nga Banka Evropiane e Investimeve (Kredi)

Vlera prej 646,187 EUR, nga Qeveria Shqiptare (mbulim i TVSH)

Sipas kësaj shkrese vlera e kredisë është 2,432,541 EUR, ndërsa sipas shkresës së Ministrisë e Financës nr. 109, datë 11.10.2013 është 2,403, 848 EUR, *me një diferencë në shumën 28,693 EUR.*

Me shkresën nr. 1820, datë 24.07.2014, protokolluar në UKS SHA me nr. 170, datë 10.09.2014 është cilësuar se:

- Nga koha e përfundimit të kontratës 31.12.2011 deri në 24.07.2014, UKS SHA është ngarkuar nga ministria e linjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e impiantit deri në përfundim të lidhjes së tyre me rrjetet përkatëse të kanalizimeve.

- PIU i Ujit në ministrinë e linjës kërkon nga UKS SHA si përfutues që të marrë në dorëzim objektin.

- **Me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014** të Administratorit të UKS SHA, i është kthyer përgjigje Ministrisë, ku është relatuar se objekti nuk mund të merret në dorëzim, pasi mbart problematika të shumta të cilat kanë sjellë mosfunksionimin e tij.

- Me shkresat nr. 198, datë 21.06.2016 dhe 230/1, datë 15.07.2016 drejtuar DPUK/AKUK, nga ana e Administratorit, është bërë me dije se "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura" ITUN, nuk është në funksion për shkaqet të cilat janë bërë prezent me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014.

Theksojmë se vlera totale e financimit për këtë investim është në shumën 3,877,126.92 EUR, nga e cila vlera e kredisë është 2,403,848 EUR (referuar MF). **Ky investim nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është vënë në përdorim për shkak të mosplotësimit të një sërë komponentësh të kësaj kontrate si: Tubacionet e dërgimit të ujërave kanë rezultuar me çarje; Impianti nuk është vendosur asnjëherë në punë dhe pjesa më e madhe e pajisjeve nuk punojnë;**

⁷ Regjistruar në kontabilitet sipas kursit të këmbimit të datës 31.12.2017 (2,403,848 EUR * 132.9 Lekë/EUR =319,591,667 Lekë)

Pompa e furnizimit me ujë të impiantit nuk punon; Pajisjet e pastrimit të grilave nuk punojnë etj. Nga ana tjetër sipas Marrëveshjes së nën-huasë UKS SHA, duhet të paguajë detyrimet e huasë në vlerën prej 2,403,848.57 EUR (referuar MF)

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Përgjegjësja e Zyrës së Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të saktësojnë vlerën e nën-huasë, referuar vlerës së nënshkruar sipas Marrëveshjes së nën-huasë, datë 04.05.2003, bazuar në Marrëveshjen e kredisë.

1.2. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS SHA, duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtitit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim.

UKS SHA të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.

Menjherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se UKS SHA ka lidhur Marrëveshje nën-huaje në datë 07.07.2003 me Ministrinë e Financës për shumën 1,390,000 SDR, mbështetur në Marrëveshjen e kredisë së Ministrisë së Financave me IDA me objekt “Projekti bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime”. Sipas Marrëveshjes së nën-huasë në UKS SHA, do të investohej shuma prej 1,390,000 SDR e barabartë me 1,954,443 USD ose me 233,408,800 lekë⁸.

-Sipas rakordimit me Ministrinë e Financave në 31.12.2017, vlera e disbursuar paraqitet në shumën 2,530,820.86 USD, ndërsa vlera e kredisë sipas Marrëveshjes së nën-huasë e shprehur në dollarë është 1,954,443 USD, me një mos rakordim në shumën 576,377 USD.

-Sipas dokumentacionit (situacione dhe fatura) që disponon UKS SHA, është justifikuar përdorimi i fondeve në vlerën 133,040,349 lekë, ndërsa vlera e financimit e shprehur në lekë në datë 07.07.2003 është 233,408,800 lekë. **Për diferencën në 100,368,451 lekë, nga zbatuesi i projektit (DPUK/AKUK) nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (pranë UKS SHA) sipas natyrës së shpenzimeve të kryera në kuadër të këtij projekti.**

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1.Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Përgjegjësja e Zyrës së Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të saktësojnë vlerën e nën-huasë, referuar vlerës së nënshkruar sipas Marrëveshjes së nën-huasë, datë 07.07.2003.

2.2.Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime (ish DPUK), PIU e Ujit, Ministrinë e linjës dhe Ministrinë e Financave, të marrin masa të menjëhershme për analizimin e situatës, të saktësojnë edhe njëherë vlerën e shpenzimeve sipas natyrës dhe dokumentacionit justifikues përkatës, të kryer në kuadër të këtij projekti, si dhe të **evidentojnë statusin e vlerës prej 100,368,451 lekë**, për të cilat UKS SHA, nuk disponon dokumentacionin përkatës dhe destinacionin e përdorimit e kësaj vlere.

Menjherë

⁸ Sipas kursit të këmbimit SDR/USD dhe SDR/Lekë në datën e lidhjes së Marrëveshjes së nën-huasë 07.07. 2003.

3. Gjetje nga auditimi: Për “Marrëveshjet e nën-huasë” të lidhura midis UKS SHA dhe Ministrisë së Financave, bazuar në “Marrëveshjet e kredisë” të lidhura midis Ministrisë së Financave me BEI dhe IDA, shpenzimet për interesa, respektivisht në shumën 353,839.23 EUR sipas kredisë së BEI dhe në shumën 366,248.62 USD sipas kredisë me IDA, penalitetet në shumën 74,072.19 EUR për mos shlyerje në afat të detyrimeve të kredisë me BEI dhe shpenzimet për komisione në vlerën 877.13 USD për kredinë me IDA, (kosto e kredive), nuk kanë rënduar periudhat përkatëse ushtrimore, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë akumuluar deri në fund të vitit 2017, në total në shumën 427,911.42 EUR dhe 367,125.75 USD.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit, Administratori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrin masa të menjëhershme për regjistrimin në kontabilitet në shpenzimeve të akumuluarra deri në 31.12.2018, për koston e kredive në total në shumën 427,911.42 EUR dhe 367,125.75 USD.

Menjëherë

4.1. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka pasqyruar efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit të fund vitit për zërat monetarë të pozicionit financiar, pasi nuk ka kontabilizuar detyrimin e lindur sipas marrëveshjes së nën-huasë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe gjithë veprimet e tjera që rrjedhin prej saj, bazuar në SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit”.

Nuk janë pasqyruar në aktiv dhe në pasiv respektivisht në llogaritë 476 “Diferenca konvertimi aktive” dhe 477 “Diferenca konvertimi pasive” me kundërparti llogaritë e shpenzimeve financiare (llogaria 666 “Humbje nga këmbimi”) dhe ne te ardhurat financiare (llogaria 766 “Fitime nga këmbimi”).

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1. Rekomandimi: Administratori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Financës, të marrin masa për korrigjimin e veprimeve kontabël, për llogaritjen e diferencave nga konvertimi në fund të çdo viti ushtrimor, duke filluar nga viti 2008-2018, me kursin e këmbimit të fund vitit përkatës, si dhe reflektimin e rezultatit, në pasqyrat financiare të vitit 2018.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Duhet cilësuar se UKS SHA për kërkesat e arkëtueshme dhe në veçanti për abonentët pasivë në vlerën 47,972,672 lekë, nuk ka bërë analizë me qëllim vlerësimin e llogarive të arkëtueshme, vjetërsinë e tyre dhe procedurat për njohjen e provizioneve. Për këtë shkak, për vlerat mbi një vit të kërkesave të arkëtueshme drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin të tyre, sipas Standardit të kontabilitetit, SKK3, “Instrumentat Financiare”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1. Rekomandimi: Administratori dhe Përgjegjësi i zyrës së Financës të marrin masa për kryerjen e zhvlerësimit të zërit të kërkesave të arkëtueshme, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i vërtetë e i besueshëm i pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e Zyrës së Financës, nuk është bërë derdhja në favor të ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë për periudhën objekt auditimi i shumës prej **2,285,600 lekë**, si vlerë e kontributit në masën 1% ndaj fondit të planifikuar të pagave të UKS SHA, në kundërshtim me ligjin nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit, Administratori dhe Zyra Financës, të marrin masa për përlogaritjen dhe derdhjen në vijimësi në favor të të përndjekurve politikë të shumës prej 2,285,600 lekë.

Menjëherë dhe vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Asambleja e Përgjithshme e UKS SHA, nuk ka shqyrtuar, aprovuar pasqyrat financiare dhe vendosur për rezultatin e periudhës brenda afateve ligjore. Pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017 në organet tatimore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 31 Mars nga UKS SHA, ndërsa nga Asambleja e Përgjithshme pasqyrat financiare të vitit 2016, janë miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.03.2018 dhe pasqyrat financiare të vitit 2017 deri në momentin e auditimit (20.09.2018), nuk janë miratuar ende. Për rrjedhojë janë aplikuar penalitete nga organet përkatëse.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1. Rekomandim: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme të marrin masa të menjëhershme, për shqyrtimin dhe miratimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2017, si dhe zbatimin e afateve të miratimit dhe dorëzimit e tyre në organet përkatëse (Drejtori Tatimore dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit), të Pasqyrave Financiare për periudhat ushtrimore në vazhdim.

Menjëherë dhe vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga këqyrja e regjistrit të mbledhjeve të Këshillit të Administrimit (KA) rezulton se, jo në të gjitha rastet është firmosur pjesëmarrja nga anëtarët e Këshillit i Administrimit, konkretisht mbledhjet nga data 20.06.2016-19.05.2016, janë nënshkruar vetëm nga dy anëtarë të KA dhe mbledhjet nga data 09.08.2017-13.03.2018, janë nënshkruar vetëm nga një anëtar i KA. Në asnjë rast nuk është nënshkruar regjistri mbi pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit të Administrimit, nga z. SHEME LULO, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UKS SHA, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1. Rekomandim: Këshilli i Administrimit dhe Sekretari i Këshillit të Administrimit, të marrin masa për plotësimin e regjistrit të mbledhjeve, si dhe nënshkrimin mbi pjesëmarrjen në këto mbledhje të secilit anëtar të Këshillit të Administrimit.

Menjëherë dhe vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, anëtarët e Këshillit të Administrimit, të emëruar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 2, datë 30.05.2016, nuk kanë lidhur kontratën e performancës me UKS SHA, sipas detyrimit të përcaktuar në VKM nr. 63, datë

27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1. Rekomandim: Anëtarët e Këshillit të Administrimit të marrin masa të menjëhershme për lidhjen e kontratës me UKS SHA, ku të përcaktojnë në mënyrë të qartë indikatorët e performancës që duhet të realizojnë në terma vjetorë, në përputhje me biznes-planin e shoqërisë, si dhe miratimin e tyre në ministrinë e linjës.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga njëri prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit, më datë 12.03.2018, është paraqitur dorëheqje e parevokueshme nga pozicioni i Anëtarit të Këshillit të Administrimit në UKS SHA.

-Që prej datës 12.03.2018, Këshilli i Administrimit është i përbërë nga 2 anëtarë, duke mos mundësuar vendimmarrjet për shkak të mosplotësimit të numrit minimal ligjor (tre anëtarë).

-Vendimet e marra nga Këshilli i Administrimit që prej datës 16.10.2017 janë marrë vetëm prej 2 anëtarëve.

-Nga ana e Administratorit nuk është kërkuar mbledhja urgjente e Asamblesë së Përgjithshme për zëvendësimin e anëtarit të tretë të Këshillit të Administrimit dhe sigurimin e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1.Rekomandim: Administratori duhet të kërkojë mbledhjen e menjëhershme të Asamblesë së Përgjithshme të UKS SHA, me qëllim zgjedhjen e anëtarit të tretë të Këshillit të Administrimit, plotësimin e kuorumit të domosdoshëm për marrjen e vendimeve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës objekt auditimi Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur çdo muaj, sipas kërkesave të Statutit të UKS SHA, fakt i cili ndikon në mos ndjekjen dhe mos analizimin në kohë të ecurisë së shoqërisë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.1. Rekomandim: Administratori, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit, duhet të sigurojë mbledhjen e Këshillit të Administrimit çdo muaj, me qëllim ndjekjen e problematikave, ecurisë së UKS SHA dhe marrjen e vendimeve në kohën e duhur.

Menjëherë dhe vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga Administratori janë marrë vendime të shumta për emërim në detyrë të punonjësve, si dhe përcaktimit të pagës sipas pozicionit që janë emëruar. Nga këqyrja e vendimeve rezultoi se, nga ana e Administratorit të UKS SHA, është vepruar në tejkallim të kompetencave të tij, pasi Administratori nuk ka tagër për të caktuar nivelin e pagave, shpërblimeve, si dhe për të vendosur nivele të ndryshme page për pozicione të njëjta pune.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12.1. Rekomandim: Administratori dhe Këshilli i Administrimit i UKS SHA Sarandë, duhet të marrin masa të menjëhershme, për përcaktimin e klasave sipas pozicioneve të punës, nivelit të pagave sipas klasave, shqyrtimin dhe miratimin e tyre në Këshillin e Administrimit si dhe miratimin e tyre nga Asambleja e Përgjithshme.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Administratorit nuk janë paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Administrimit pasqyrat financiare të viteve 2016 dhe 2017. Gjithashtu, edhe nga Këshilli i Administrimit, nuk rezultoi të jetë thirrur administratori për të paraqitur në KA pasqyrat financiare të viteve 2016 dhe 2017, me qëllim shqyrtimin, kontrollin dhe miratimin e tyre.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13.1. Rekomandimi: Administratori duhet të marrë masa për paraqitjen në Këshillin e Administrimit për shqyrtim, kontroll dhe miratim të pasqyrave financiare, pas auditimit nga eksperti kontabël.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 1, datë 16.03.2018 janë emëruar ekspertët kontabël për miratimin e pasqyrave financiare të viti 2017, me të cilët është lidhur Kontrata datë 30.06.2018, protokolluar me nr. 482, datë 02.07.2018. Si rezultat i kësaj vonese Raporti mbi pasqyrat financiare të vitit 2017 i përgatitur nga ekspertët kontabël, është dorëzuar sipas protokollit nr. 610, datë 24.09.2018, ndërkohë që afatet e dorëzimit dhe publikimit të pasqyrave financiare në Drejtorinë Tatimore dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit, janë 31 Mars dhe 31 Korrik të vitit pasardhës. Kjo ka sjellë që dorëzimi i pasqyrave financiare në organet përkatëse është bërë pa dalë raporti nga eksperti kontabël.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14.1. Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme duhet të marrin masa për emërimin në kohën e duhur të Ekspertit Kontabël, me qëllim auditimin e pasqyrave financiare të UKS SHA, përpara publikimit të tyre.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se jo në të gjitha rastet regjistrimi në kontabilitet i pasurive të paluajtshme (troje dhe ndërtesa) është mbështetur në dokumentacionin e duhur, pasi jo në të gjitha aktivet (troje dhe ndërtesa) janë të pajisura me dokumentin e pronësisë (certifikatë apo vërtetim hipotekor), apo dokument tjetër që vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

15.1. Rekomandimi: Administratori, Juristi i UKS SHA dhe Zyra e Financës, të marrin masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për pajisjen me dokumente të pronësisë të të gjitha pasurive të paluajtshme të cilat janë në inventar, si dhe të përfshira në pasqyrat financiare të UKS SHA.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se një pjesë e aktiveve të cilat kanë hyrë në inventar në periudha të mëparshme, rezultojnë me vlera të pa përditësuara me vlerën aktuale të tregut (“Ish magazina, zyrat e reja”, “Repartit zdrukthtarisë”, “Vendi rojës+stacioni pompimit Vrion” etj.), referuar SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”. Me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, me marrjen në dorëzim të aktiveve të Ksamilit, u bë rivlerësim vetëm i tyre pa përfshirë aktivet që dispononte UKS.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Zyra e Financës, Këshilli i Administrimit të marrin masa për fillimin e procedurave të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, të cilat

rezultojnë me vlerë të pa përditësuar me vlerën aktuale të tregut, duke mos pasqyruar drejtë vlerën reale të tyre në aktiv të bilancit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Bashkëngjitur veprimeve të kryera me bankë, mungonte dokumentacioni autorizues i shpenzimit, si urdhra blerje, kontrata, etj., si dhe dokumentacioni vërtetues i shpenzimit të kryer, ku pjesa më e madhe e dokumentacionit rezultonte të ishte fotokopje, si dhe nuk ishte i plotë përsa i përket mungesës në disa raste të fletëhyrjeve, situacioneve, akt-marrjeve në dorëzim etj. Megjithatë parregullsitë e mësipërme kanë të bëjnë me keq organizimin e mbajtjes së dokumentacionit të veprimeve me bankë, pasi në disa raste me zgjedhje u kërkua dokumentacioni origjinal i transaksioneve të kryera dhe na u vu në dispozicion.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17.1. Rekomandimi: Përgjegjësja e Zyrës së Financës të marrë masa të menjëhershme, për dokumentimin e veprimeve të kryera me bankë në dy aspekte, konkretisht: dokumentacionin autorizues dhe dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, duke bashkëngjitur dokumentacionit origjinal për çdo transaksion të kryer.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Administratorit të UKS nuk ka dalë urdhër për ngritje të komisionit për përcaktimin e normativave të harxhimit të karburantit. Normativat e harxhimit të karburantit për 100/km, për secilin mjet transporti, apo orë/punë për makineritë e palëvizshme, të cilat aplikohen nga UKS SHA, ekzistojnë si draft, të pa miratuara nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

18.1. Rekomandimi: Administratori të marrë masa të menjëhershme për rishikimin e draftit ekzistues mbi normativat e karburantit, shqyrtimin dhe miratimin e tyre, nxjerrjen e urdhrat përkatës për zbatim nga përdoruesit e mjeteve të UKS SHA.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga këqyrja e dokumentacionit justifikues për konsumin e karburantit nga drejtuesit e mjeteve rezultuan parregullsi të shumta si më poshtë:

- Mungon në të gjitha rastet urdhri i punës për lëvizjen e mjetit, arsyen, si dhe itinerarin që do të përshkruajë mjeti;

- Lëvizjet e përshkruara në Fletë-udhëtimi, nga ana e drejtuesve të mjetit, nuk janë të nënshkruara as prej tyre, as nga personi urdhërues, apo udhëtues, si dhe as nga përgjegjësi i Sektorit referuar formatit të fletë-udhëtimit apo fletës së punës.

- Në fletën e udhëtimit ka korrigjime të shumta përsa ju përket km të përshkruara referuar distancave.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

19.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës i cili duhet të hartojë udhëzimin mbi mënyrën e administrimit të karburantit për nevoja të shoqërisë, ku të përcaktohet personi urdhërues dhe arsyeja e lëvizjes së mjetit, drejtuesi i mjetit, personi udhëtues/specialistë, si dhe personi përgjegjës i cili duhet të konfirmojë prezencën e mjetit dhe kryerjen e shërbimit. Të përcaktojë formatin tip të urdhër i shërbimit, fletës së udhëtimit dhe fletës së punës dhe personin përgjegjës për administrimin e shpenzimeve

të karburantit dhe rakordimin nga ana e tij me Zyrën e Financës. Pas paraqitjes nga grupi i punës dhe shqyrtimit të këtyre dokumenteve, Administratori duhet të nxjerrë urdhër për miratimin e tyre.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në strukturën organizative të shoqërisë mungojnë postet e punës, drejtor/departament teknik dhe drejtor/departament tregtar, poste të cilët janë detyrim për të gjithë shoqëritë e UK, përcaktuar në VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe Statutin e Shoqërisë miratuar me Vendimin nr. 1, datë 30.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

20.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës organizative të UKS SHA, me postin e Departamentit/Drejtorisë Teknike dhe Departamentit/Drejtorisë Tregtare.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e brendshme për UKS SHA, është miratuar në vitin 2006 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe Statutin e ndryshuar të Shoqërisë, duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Rregullorja e brendshme vazhdon të jetë e njëjta sipas organizimit të mëparshëm të shoqërisë. Nga ana e strukturave drejtuese nuk është marrë asnjë masë për përshtatjen apo hartimin e një rregulloreje të re.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

21.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit, të marrin masa të menjëhershme për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të UKS SHA, menjëherë pas miratimit të strukturës organizative, ku të pasqyrohet mënyra e organizimit, funksionimit të UKS, përshkrimi i punës sipas pozicioneve përkatëse, ndarja e detyrave, përgjegjësi dhe të drejtave për secilin post pune.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: UKS SHA, nuk ka përcaktuar kritere dhe procedura për mënyrën e rekrutimit të stafit, si dhe nuk janë ndjekur procedura për shpalljen dhe plotësimin e vendeve vakante. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të miratuar, as të kritereve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj., pasi emërimi i punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi është kryer me urdhër të administratorit të shoqërisë, pa asnjë kriter tjetër.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

22.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit, të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e procedurave të rregullta për emërimet në punë, duke zhvilluar një proces transparent, i cili fillon me përcaktimin e kritereve, shpalljen dhe publikimin e vendeve vakante, si dhe përzgjedhjen e tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në rregulloren e brendshme, në kontratat individuale dhe në mungesë të kontratave kolektive nuk specifikohet përmbajtja e dosjes së personelit. Mbi auditimin me zgjedhje të 20 dosjeve të personelit grupi i auditimit është

mbështetur në listën e dokumenteve të kontratave kolektive të viteve para periudhës objekt auditimi si dhe në eksperiencat e ngjashme nga ku u konstatua se:

- Në asnjë nga kontratat individuale nuk specifikohet paga dhe elementet përbërës të saj.
- Në disa raste mungonte CV e punonjësit, diplomat universitare në pjesën më të madhe të dosjeve ishin të pa noterizuara, në disa raste mungonte librezat e punës, mungonte fleta e inventarizimit dhe librezat e sigurimeve shoqërore në të gjitha dosjet.
- Gjithashtu u evidentuan raste të dosjeve vetëm me kontratën e personit të punësuar dhe asnjë dokumentacion tjetër.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

23.1. Rekomandimi: Zyra e Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e duhur (origjinal/ose fotokopje të noterizuara), inventarizimin e tyre, si dhe indeksimin e tyre sipas regjistrit të personelit.

23.2. Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa të menjëhershme për plotësimin e kontratave individuale të punës me të gjithë elementët e duhur përsa i përket pagës së punonjësve.

Menjëherë dhe vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në kontratat individuale të punonjësve me UKS SHA, citohet se: “Punëmarrësi do të përfitojë shpërblimet që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe shpërblimet e tjera të përcaktuara në Vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë në përputhje me kontratën kolektive në fuqi”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti rezulton se Kontrata e fundit kolektive ka qenë në fuqi nga viti 2009 deri në vitin 2012. Kështu pas vitit 2012, nuk mund të jetë referencë për kontratat individuale.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

24.1. Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të marrin masa të menjëhershme për rishikimin dhe miratimin e “Kontratës kolektive të punës”.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Në strukturën e vitit 2016 janë konstatuar diferenca në nivelin e pagave për të njëjtin pozicion pune. E njëjta problematikë në përcaktimin e nivelit të pagave ka vazhduar edhe në vitet 2017 dhe 2018 edhe pse me vendim të Këshillit Administrativ nr. 15/2 datë 20.12.2017, u miratua unifikimi i pagave për punonjësit brenda të njëjtës kategori.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

25.1. Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave të tilla dhe zbatimin e nivelit të njëjtë të pagave për pozicione të njëjta pune.

Menjëherë dhe vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë-pagesave është konstatuar se, paga bruto nuk përmban elementët përbërës të saj. Nuk trajtohen elementët përbërës të saj si, paga bazë ose paga e grupit, shtesa për pozicion, shtesa për vjetërsi pune, niveli i diplomës dhe kualifikimit, si dhe shtesa të tjera të parashikuara.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

26.1. Rekomandimi: Administratori, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e drejtë të pagës bazë, mbi të cilën do të përlllogariten elementët shtesë (pagës bruto) dhe mbi këtë elementët pakësues (paga neto).

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: U konstatua se lëvizjet e pozicioneve të punës për ulje dhe ngritje në kategori, janë kryer vetëm me vendim të titullarit, pa u mbështetur në kriteret e performancës në punë, pasi nuk është aplikuar vlerësimi i punonjësve në fund të periudhave ushtrimore. Gjithashtu, këto ndryshime nuk janë shoqëruar me ndryshime në nivelin e pagave, sipas pozicioneve të reja përkatëse.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

27.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e indikatorëve/kritereve, mbi vlerësimin e rezultateve në punë të stafit, përcaktimin e rregullave të procesit të vlerësimit, si dhe lëvizjen e stafit (ngritje/ulje në detyrë) në bazë të rezultateve dhe performancës së tyre në punë.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se gjatë viteve 2016 dhe 2017 janë dhënë shpërblime për orë jashtë orarit zyrtar të punës në shumën 1,875,500 lekë, për të cilat nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës, nuk ishin zbatuar procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe nuk ishin justifikuar me dokumentacionin e plotë përkatës.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

28.1. Rekomandimi: Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës, të marrin masa të menjëhershme për dokumentimin e gjithë procedurave të nevojshme për identifikimin dhe kërkesën sipas nevojave, argumentimin, kryerjen, prezencën e punonjësve dhe masën shpërblimit, në rastet e kryerjes së punës jashtë orarit zyrtar të saj.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: UKS SHA ka hartuar Plan-biznesin afatmesëm, të cilin e ka aprovuar në Këshillin Mbikëqyrës, në vitin 2014, por nuk e ka të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme (AP) të shoqërisë. Gjithashtu, UKS SHA nuk ka hartuar programet ekonomike vjetore, për periudhën objekt auditimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

29.1 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit të UKS SHA, duhet të marrin masa të menjëhershme për rishikimin e Plan-biznesit, si dhe diskutimin dhe miratimin e tij në Këshillin e Administrimit dhe më tej në Asamblenë e Përgjithshme të UKS SHA.

29.1.Rekomandimi: Administratori i UKS duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin e Programeve ekonomike, miratimin e tyre në organet kolegjiale, për vitet në vijim, në përputhje me Plan-Biznesin e shoqërisë, me qëllim përcaktimin e treguesve ekonomiko-financiarë, si të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë, fitimi/humbjen, kapitalin, likuiditetet etj., me qëllim marrjen e vendimeve bazuar në analizën e tyre.

Menjëherë

30. Gjetje: Nisur nga viti 2017 (viti me performancën më të mirë) rezulton se shoqëria ka faturuar 1,665,196 m³ ujë, nga 5,195,467 m³ ujë të prodhuar, ose 32.05% e sasisë totale të deklaruar se ka prodhuar, ku humbjet prodhim-faturim janë 68%. Nga kjo sasi, është arkëtuar vlera prej 11,637,545 lekë, që përkon me 86.9% arkëtime ndaj faturimit, ose **27,85% ndaj prodhimit**. Pavarësisht një përmirësimi në krahasim me periudhat e mëparshme, treguesit e mësipërm flasin për një performancë të ulët të UKS SHA, në lidhje me nivelin e faturimit dhe arkëtimit. Niveli i arkëtimit reflektohet edhe në nivelin e lartë të debitorëve i cili pavarësisht një përmirësimi të lehtë në krahasim me vitin 2016, vazhdon të jetë në nivele të larta.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

30.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë në analizë shkaqet e nivelit të lartë të mos faturimit, nxjerrjen e përgjegjësive si dhe marrjen e masave të menjëhershme për identifikimin e të gjithë përdoruesve të ujit të prodhuar nga UKS SHA, me qëllim rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimeve/të ardhurave të shoqërisë.

30.2. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë në analizë shkaqet e mos shlyerjes së detyrimeve nga klientët (familjarë, shtetërorë, biznese etj) nxjerrjen e përgjegjësive si dhe marrjen e masave të menjëhershme detyruese dhe shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve.

Menjëherë

31. Gjetje nga auditimi: Analiza e ujit sipas të dhënave të laboratorit të shoqërisë bëhet për 19 prej 67 analizash të specifikuara në VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” shtojca I “Kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, parametrat, vlerat e tyre dhe metodat standarde të analizave”. Analizat bëhen me metoda instrumentale që japin një siguri të arsyeshme se rezultatet e tyre janë të pranueshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

31.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë masa për kryerjen të gjithë spektrit të analizave të ujit sipas rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, shtojca I “Kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, parametrat, vlerat e tyre dhe metodat standarde të analizave”.

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2017, rezulton se janë 19,123 abonentë, nga të cilët 14,488 janë me matës, ndërsa 4,635 pa matës që përbëjnë 32% të abonentëve. Në numrin e abonentëve pa matës rezultojnë edhe 1,865 abonentë të cilët paguajnë një tarifë shërbimi të përlllogaritur “afro-fe”, gjë që nuk është e autorizuar nga ERRU as direkt me Vendimin nr. 6, datë 26.08.2005, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik SHA Ujësjetës Kanalizime Sarandë”, por as me vendime të përgjithshme të ERRU. Njëkohësisht metodologjia për abonentët tregtar, ku fatura “afro-fe” përlllogaritet sipas një metode komplekse, në të cilën faturisti duhet të menaxhojë të dhëna që nuk disponohen nga SHA UKS, por nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

32.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë masa për ndërprerjen e praktikës së faturimit afro-fe, si dhe pajisjen e abonentëve me matës uji.

Menjëherë

33. Gjetje nga auditimi: Komisionet e inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAMGJ) dhe Aktiveve Afatshkurta Materiale (AASHM) nuk kanë kryer procedurën e plotë të inventarizimeve lidhur me identifikimin e numrit të fletëhyrjes dhe fletëdaljes, së gjetur në momentin e fillimit të inventarizimit, vulosjen e magazinës, identifikimin e aktiveve sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011, për gjendjen e tyre dhe përgjegjësin material. AAGJM të gjetura në magazinë nuk janë trajtuar në inventar nga komisioni i AAGJM por nga komisioni i AASHM, kjo edhe për shkak të mënyrës paraqitjes së gjendjes kontabël të tyre së bashku, jo veçmas. Asnjë prej procesverbaleve të inventarizimit nuk është protokolluar në arshivën e shoqërisë, si detyrimin i përcaktuar në urdhrin e inventarizimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

33.1.Rekomandim: Administratori dhe Zyra e Financës të marrin masa për kartelizimin dhe regjistrimin në kartelat përkatëse të të gjitha ndryshimeve (shitesa/pakësime) të ndodhura gjatë periudhave ushtrimore.

33.2. Rekomandim: Të merren masa që në të ardhmen kryerja e inventarizimit të bëhet nga komisionet përkatëse, në përputhje me llojet e aktiveve (afatgjatë dhe afatshkurtra).

Menjëherë dhe vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i blerjeve në vlerë të vogël është konstatuar se në shumicën e rasteve, mungojnë kontratat midis operatorit ekonomik të shpallur fitues dhe UKS SHA. UKS SHA, pas shpalljes së fituesit, ka kryer veprimet e dorëzimit të mallit, por pa asnjë përcaktim ligjor në kontratë. Pra, pa kushte lëvrimit të mallit, por vetëm me procesverbale të marrjes në dorëzim dhe fletë-hyrje.

Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

34.1. Rekomandimi: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor duhet të marrë masa të menjëhershme, që për procedurat e finalizuara të prokurimit në vlerën mbi 100,000 lekë të lidhë kontratat përkatëse me OE të shpallur fitues, me qëllim ndjekjen e tyre dhe krijimin e kushteve për nxjerrjen e përgjegjësive dhe vendosjen e penalteteve, në rast të mosplotësimit të kushteve kontraktuale.

Menjëherë

35. Gjetje nga auditimi: Në kontratën “Marrëveshje kuadër” të lidhur mes UKS SHA dhe OE “...” SHPK me objekt “Blerje matësa uji ½ me rakorderi”, në nenin 1 të kontratës së lidhur, citohet se “...Vlera e kontratës nuk do të tejkalojë vlerën e vendosur në dispozicion prej 11,974,500 lekë pa TVSH”. Në fakt, kjo është vlera e fondit limit të përcaktuar nga UKS SHA dhe jo vlera e kontratës ose e ofertës së shpallur fituese që është 10,890,000 lekë pa TVSH, për rrjedhojë UKS SHA, duhej të vendoste si kriter mos tejkalimin e vlerës së shpallur fituese dhe jo vlerën e fondit limit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

35.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për të negociuar me kontraktuesin “...” SHPK, për ndryshimin e vlerës totale të kontratës “Marrëveshje kuadër” nga 11,974,500 lekë pa TVSH, vlerë e cila përkon me vlerën limit të kontratës, në vlerën 10,890,000 lekë vlerë e cila përkon me ofertën fituese (sasi*çmim për njësi), të paraqitur nga kontraktori “...” SHPK në Dokumentet e Tenderit.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua copëzim fondi. Konkretisht urdhrat e prokurimit me nr. 4 dhe nr. 5 të datës 21.02.2018 dhe nr. 12 të datës 27.02.2018, kanë si objekt “Ndërtim ujësjellësi për ujërat e zeza ose të bardha”, janë brenda një muaji dhe nëse do të prokurohej njëherë të vetme, fondi limit do të ishte 2,328,414 lekë, ç’ka sipas LPP-së duhet të zbatoheshin procedura prokurimi mbi kufirin e ulët monetar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

36.1. Rekomandimi: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor duhet të marrë masa, për ndërprerjen e praktikave të copëzimit të fondeve, në rast të prokurimit të mallrave apo grup mallrave të së njëjtës natyrë, të shërbimeve apo punëve publike, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me fondin limit të përlllogaritur për to dhe kufijtë monetarë të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, stafi nuk ka njohuri mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, me komponentët e tij. Mungon Strategjia e Riskut dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk është hartuar një regjistër risku në nivel njësie, për aktivitetet dhe operacionet kryesore nuk ka procedura të shkruara, nuk ka një manual të shkruar për përdorimin dhe ruajtjen e sistemeve, aktiveve dhe për mënyrën e komunikimit brenda dhe jashtë njësisë. Mungon përcaktimi i gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

37.1. Rekomandimi: Administratori, në cilësinë e Titullarit të njësisë, duhet të marrë masa për njohjen dhe zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nga i gjithë stafi i UKS SHA, me qëllim funksionimin e të gjithë komponentëve të tij përbërës, Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi.

Menjëherë

C.1 MASA SHPËBLIM DËMI:

Nga Administratori i Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **711,556 lekë**, përfituar më tepër, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga këqyrja e dokumentacionit justifikues për konsumin e karburantit nga drejtuesit e mjeteve rezultuan parregullsi të shumta si më poshtë:

- Mungon në të gjitha rastet urdhri i punës për lëvizjen e mjetit, arsyen, si dhe itinerarin që do të përshkruajë;

- Lëvizjet e përshkruara në Fletë-udhëtimi, nga ana e drejtuesve të mjetit, nuk janë të nënshkruara as prej tyre, as nga personi urdhërues, apo udhëtues, si dhe as nga përgjegjësi i Sektorit referuar formatit të fletë-udhëtimit apo fletës së punës.

- Në fletën e udhëtimit ka korrigjime të shumta përsa ju përket km të përshkruara referuar distancave.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Zyra e Financës marrë masa për zhdëmtimin nga secili prej përdoruesve të mjetit (sipas aneksit bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit pas përlogaritjes së vlerës në lekë sipas çmimit përkatës), të sasisë së karburantit prej 2745 litra, afërsisht në vlerën **378,810 lekë**, të pajustificuar me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit (KA), nga Zyra e Financës nuk është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore.

Konkretisht në vitin 2017, janë paguar dy anëtarët e KA, z. S.K. dhe z. A.L., në 4 raste kur KA nuk është mbledhur, si dhe për vitin 2018 është paguar z. Sotir Koçi për muajt Prill, Maj dhe Qershor pa u mbledhur KA, duke përfituar padrejtësisht vlerën respektive prej 123,760 lekë dhe 70,720 lekë. Shpërblimi i z. S.K. është ndërprerë në muajin Korrik me argumentimin se KA nuk po mbledhet për shkak të mungesës së dorëheqjes së anëtarit të tretë z. A.L. dhe mosplotësim të kuorumit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandim: Administratori i UKS SHA, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së shpërblimeve të përfutur padrejtësisht, për pjesëmarrje në mbledhjet e KA, nga anëtarët e tij, përkatësisht z. S.K. në shumën 123,760 lekë dhe z. A.L. në shumën 70,720 lekë.

Menjëherë

3. Nga auditimi i zbatimit të Kontratës me objekt “Ndërtim i rrjetit U. Z. në zonën Qendër Rruga Onhezmi, Adem Sheme, Skënderbeu” të lidhur mes UKS SHA dhe OE “...” SHPK, ka rezultuar se është realizuar me 19 ditë vonesë, gjë për të cilën nga Autoriteti Kontraktor nuk janë përlogaritur penalitetet të cilat janë në vlerën 60,169 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 60,169 lekë, të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të zbatimit me vonesë të kontratës nga OE dhe mosaplikimit të penaliteteve për këtë vlerë nga Autoriteti Kontraktor.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Rehabilitim dhe investim me pompa të reja, Stacioni Pompimit Çukë” të lidhur mes UKS SHA dhe OE “...” SHPK, ka rezultuar se nuk janë zbatuar punime në vlerën 59,508 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 59,508 lekë, të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të punimeve të pakryera nga kontraktori “...” SHPK.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të Kontratës “Devijim i ujërave të zeza nga tubacioni d=400 mm me presion në tubacionin d=800 mm me rrjedhje të lirë” të lidhur mes UKS SHA dhe OE “...” SHPK me fond limit 1,549,080 lekë me TVSH, ka rezultuar se ka vonesë në realizimin e kontratës për të cilat nga AK nuk është aplikuar penaliteti në shumën 18,589 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës në 18,589 lekë, të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të mos aplikimit të penalitetit, për vonesë në realizimin e kontratës nga ana e kontraktorit “...” SHPK.

Menjëherë

C.2 MASA PR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2015 me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 22/21 datë 22.04.2015, është miratuar struktura e re shoqërisë, si rezultat i ndarjes territoriale për 118 punonjës, nga të cilët 13 punonjës për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN). Për ITUN Çukë, nuk janë specifikuar pozicionet e punonjësve duke krijuar konfuzion në lidhje me numrin e saktë për pozicion. Për ndryshimet në strukturën e vitit 2016 dhe 2017, nuk ka asnjë miratim të Këshillit Administrativ, si dhe është evidentuar tejkallim me 50 punonjës mbi strukturë

(muajin nëntor 2017 numri total i punonjësve arriti 170 punonjës) duke i shkaktuar shoqërisë një **efekt financiar negativ në shumën 13,805,000 lekë.**

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS, të marrë masa të menjëhershme që të rishikojë nevojat për staf (punonjës) si dhe të plotësojë strukturën organizative të UKS në përputhje me këto nevoja dhe të miratojë numrin e punonjësve në organet drejtuese të UKS SHA.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, vetëm dy nga punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procedura gjyqësore për të cilat është marrë vendim i formës së prerë në vitin 2017 për dëmshpërblim me **vlerë totale 1,030,000 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.** Për të dy punonjësit është dhënë masa pushim nga puna, si pasojë e thyerjes së disiplinës në punë, për mosparaqitje dhe shpërdorim detyre. Nga verifikimi i procedurave për largim nga puna u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara nga kodi i punës.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e rregullave dhe procedurave, si dhe dokumentimin e tyre, në rastet e marrjes së masave disiplinore, largimit nga detyra, apo pushimit të menjëhershëm të punonjësve nga puna.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë-pagesave për vitin 2016, u konstatua se Ish Administratori D.B. me urdhrin nr. 179 datë 01.06.2016 është emëruar në detyrën e Zv/Administratorit, një pozicion ky i cili nuk është pjesë e strukturës së miratuar dhe i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Në listë-pagesën e muajit qershor edhe pse nuk vazhdon më si administrator (Vendimi i Asamblesë nr. 2 datë 01.06.2016) i shoqërisë, është paguar me pagë 85,000 lekë/muaj, ekuivalente me pagën e administratorit, si dhe për 12 muajt në vazhdim është paguar me pagë në shumën 75,000 lekë/muaj. Për rrjedhojë shuma prej **978,966 lekë përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra Financës, të marrin masa të menjëhershme ndërprerjen e praktikave të tilla, të cilat sjellin pasoja negative për buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Realizimi i kontratës “Përmirësimi i sistemit të pagesave” në shumën 3,232,212 lekë është realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Sipas kontratës pagesa për implementimin e sistemit do të kryhet pas dorëzimit të çdo zëri punimesh sipas formularit të ofertës. Nga UKS SHA është kryer likuidimi i mirëmbajtjes së sistemit për muajt Maj, Qershor dhe Korrik 2018, pasi sipas kontratës administrative fillimi i zbatimit të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) është me lidhjen e saj, ndërtimi i të cilit zgjat tre-muajt.

Nga Zyra e financës në zbatim të Kontratës nr. 308, datë 26.04.2018, janë kryer likuidime për mirëmbajtje sistemi në shumën 119,184 lekë.

Vlera vjetore e mirëmbajtjes është në shumën 476,743 lekë, nga e cila shuma prej **119,184 lekë** e likuiduar për mirëmbajtje, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës administrative, është shpenzuar pa efektivitet për shoqërinë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1. Rekomandim: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor, të marrë masa për negocimin e afatit të zbatimit të kontratës së “Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”, deri më 26.07.2019, duke përlogaritur fillimin e periudhës 1 vjeçare të mirëmbajtjes, nga data 26.07.2018, e dorëzimit të përmirësimit të sistemit nga operatori ekonomik “....” SHPK.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

D.I. Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, që bazuar në Statutin e UKS SHA, nenin 18 “Administratori i Shoqërisë”, dhe 21 “Detyrimi i besnikërisë”, të marrë masën **“Vërejtje me paralajmërim”**;

1. Për Z. Sh. L., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA, si dhe në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, për shkeljet e mëposhtme:

- Mungesë të plan biznesit të Shoqërisë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme;
- Mungesë të Programeve vjetore ekonomiko-financiare të shoqërisë;
- Mungesë e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të UKS SHA, në përputhje me ndryshimet strukturore të saj;
- Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrit të Riskut, mungesën e Pyetëtorit të Vetëvlerësimit, si dhe Gjurmës së Auditimit dhe Hartës së Proceseve, për disa aktivitete kontrolli;
- Mosmiratim të pasqyrave financiare të viteve ushtrimore 2016 dhe 2017 në Këshillin e Administrimit;
- Marrjen e vendimeve në Këshillin e Administrimit në kushtet e mosplotësimit të kuorumit të nevojshëm;

Menjëherë

D.II. Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Statutin e Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA, si dhe në Kontratën Individuale të Punës, nenin 12 “Masa disiplinore” të marrë masat disiplinore si më poshtë:

1. Për Znj. U. Sh., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, propozohet masa disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim”**, bazuar në nenin 12, pika 1, germa “d”, për shkeljet e mëposhtme:

- Mangësi të theksuara në administrimin e dosjeve të personelit;
- Mangësi të theksuara në listë-pagesat e punonjësve, të cilat gjatë periudhës 2016, janë mbajtur nga Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Mangësi në dokumentacionin e listë-prezencave në punë si dhe dokumentimin e dhënies së shpërblimeve për orë jashtë orarit zyrtar të punës.

2. Për Znj. Zh.M., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, propozohet masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**, bazuar në nenin 12, pika 1, germa “b”, për shkeljet e mëposhtme:

- Mangësi në mbajtjen në mënyrën e duhur të dokumentacionit justifikues të shpenzimeve të kryera me bankë;
- Mos kryerjen e regjistrimeve kontabël në lidhje me nënhatatë dhe koston e tyre, në momentin e njohjes së kësaj problematike, pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017;
- Regjistrim i aktiveve (pasuri të paluajtshme) në disa raste pa poseduar dokumentacion vërtetues të pronësisë;
- Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrimit të Riskut, mungesën e Pyetësorit të Vetëvlerësimit, si dhe gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për disa aktivitete kontrolli.

Menjëherë

3. Për anëtarët e Njesisë së Prokurimit:

- 3.1. V.G.
- 3.2. Z. K.
- 3.3. E. G.
- 3.4. A. V.
- 3.5. E. R.
- 3.6. A. B.

Propozohet masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**, bazuar në nenin 12, pika 1, germa “b”, për shkelje e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurat e prokurimit si më poshtë:

Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje gazoil D1” viti 2016, u konstatuan shkelje në kundërshtim me:

- LPP me ndryshime, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2;
- LPP me ndryshime, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 2;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27 “Kontrata e mallrave” pika 3;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27 “Kontrata e mallrave” pika 6, germa (c).

Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje gazoil D1” viti 2016 (shitesë kontrate), u konstatuan shkelje në kundërshtim me:

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 36 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pika 2, germa (c).

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i sistemit të faturimit”, u konstatuan shkelje në kundërshtim me:

- VKM nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar, pika 2, germa (b) dhe (c);
- Udhëzimi nr. 4099, datë 3.11.2014 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1159, datë 17.3.2014, të Ministrisë të Shtetit për inovacionin dhe administratën publike, “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, pika 5.

Menjëherë

E. Ky auditim nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është vlerësuar se nuk i ka përmbushur pritshmërinë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR